



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

Nr. 074/2024

Datë: 30.03.2024

Kryeministri i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 94 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 par.1.3 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.04/197 të datës 29 mars 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- Aprovohet ndarja e subvencioneve për gra dhe vajza që përbëjnë familje të ngushtë të personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës në Kosovë, të evidentuar në listën e pensioneve për persona të zhdukur, dhe që përmes vetëpunësimit sigurojnë përmbushjen e nevojave bazike apo mirëqenien e familjes.
- Ndarja nga pika 1 e këtij Vendimi, bëhet përmes thirrjes publike të shpallur nga Agjencia për Barazi Gjinore.
- Obligohet Agjencia për Barazi Gjinore për zbatimin e këtij Vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Drejtorit të Agjencisë për Barazi Gjinore;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.